



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:123382

Datë: 04.06.2024

Numri i dokumentit: 05777669

**P.nr.182/21**

### **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK**, Departamenti I Pergjithshem-Divizioni Penal, Gjyqtarja Zajrete Muhaxheri, me bashkëpunëtorin profesional Ismanj Kuçi në çeshtjen penale ndaj të pandehurit B.K nga fsh...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.904/21 të datës 05.07.2021 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor me dt.30.05.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit Ardian Emini dhe të pandehurit me mbrojtësin sipas detyrës zyrtare, av.F. T, në mungesë të përfaqësuesit të dëmtuarës, me dt.04.06.2024 mori, shpalli dhe përpiloi këtë:

### **A K T G J Y K I M**

I pandehuri B.K nga fsh. ...-Kaçanik, i lindur më dt.... , nga i ati I... dhe e ëma S..., e gjinisë R... , shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i martuar, prind i dy fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, I punësuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me nr.personal: ....

### **ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 18.04.2021 rreth orës 19:19, në territorin e Parkut Kombëtar “Sharri”, në vendin e quajtur “Rrafshi i Bujevës”, njësia menaxhuese Ahishta Komuna, Kaçanik, me qëllim

të përvetësimit të pasurisë së huaj të luajtshme e që vetit t'i sjell dobi pasurore të kundërligjshme, me dashje ka prerë trungje në parkun e mbrojtur në kundërshtim me Ligjin nr. 04/1 - 087 për Parkun Kombëtar "Sharri", në atë mënyrë që duke përdor sharrë motorike të markës ".." kishte prerë 4 (katër) copa drunjë të llojit të ahut, me vëllim të përgjithshëm prej 1.73 m<sup>3</sup>, dhe të njëjtat i ka ngarkuar në veturën e tij pikap të markës "... 1.9 D, ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit..., me ç' rast MMPH-Agjencisë së Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 548,50 €.

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par. 1 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,48,69,70, 71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

## **G J Y K O N**

Me dënim me kusht me të cilin i vërtetohet dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 180 ditësh, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri në afat prej 1 viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën do t'i revokohet dënimi me kusht.

Detyrohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor, të paguajë pranë kësaj gjykate, shumën prej 20.00€, ndërsa për Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej 20.00€, në afat të njëjtë me gjobën, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E dëmtuara Agjensioni për Mbrojtjen e Mjedisit pranë MMPH-Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest civil.

Konfor nenit 92 par.1 të KPRK-së dhe nenit 269 par.1 të KPPK-së, të pandehurit i konfiskohet, automjetit tip Pickup i markës "... 1.9 D" ngjyrë e bardhë, me targa të regjistrimit 05-136-EF, dhe një motor sharrë, e tipit "...".

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzën PP/II.nr.904/21 të datës 05.07.2021, të pandehurin B.K nga ...-Kaçanik, e ka akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par. 3 nënpar.3.1 të KPRK-së, dhe ka kërkuar që I njëjti të shpallet fajtor dhe të gjykohet sipas ligjit.

Ne bazë të kësaj aktakuze gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar me dt.22.11.2021 me te cilin rast, I pandehuri , pas prezentimit te aktakuzës nga prokurori I shtetit, nuk e ka pranuar plotësisht fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Ne shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 30.05.2024, prokurori I shtetit Ardian Emini, me rastin e prezentimit të aktakuzës, deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës, pa ndryshime dhe plotësime.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës, nuk ka qenë prezent në shqyrtimin gjyqësor.

I pandehuri në fjalën e tij në shqyrtimin gjyqësor, e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza, duke shtuar se pavarësisht faktit që këto dru kishte për qëllim që t'i shfrytëzojë për nevojat e ekonomisë familjare, e ndien veten të penduar për veprimin e tij dhe I premtonte gjykatës se veprime të tilla nuk do të përsërisë në të ardhmen, prandaj edhe I kërkon gjykatës, që me rastin e marrjes së vendimit, t'i shqiptohet një dënim sa më i ulët që të jetë e mundur.

Prokurori I shtetit dhe mbrojtësi I të pandehurit, nuk e kanë kundërshtuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 322 lidhur me 242 të KPP-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet ne faktet e çështjes që permban akuza, se akti akuzues nuk permban asnje shkelje te qarte ligjore apo gabime teknike andaj shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi pa administrimin e provave tjera.

Prokurori I shtetit ne fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, nga vetë pranimi I fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili vullnetarisht e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet ne barrë

sipas aktakuzës, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv, andaj edhe i propozon gjykatës që të pandehurin t'a shpall fajtor dhe t'I shqiptojë sanksion penal sipas ligjit, duke patur parasysh si rrethanë lehtësuese pranimin e fajësisë, faktin se I njejtë për here të pare ka rënë ndesh me ligjin, ndërsa si rrethanë rënduese, të ketë parasysh faktin se vepra penale është kryer në pyllin e mbrojtur dhe kjo tani është duke u shfaqur si dukuri.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare I të pandehurit, av.F. T., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi se, meqë I mbrojturi I tij e pranoi fajësinë, kërkon nga Gjykata që me rastin e shpalljes së vendimit të merret parasysh si rrethanë lehtësuese pranimi I fajësisë, mosha e re e të pandehurit, premtimi I tij se nuk do të përsërisë veprën penale, andaj I propozon gjykatës që të mbrojturit të tij t'I shqiptohet një denim sa më I butë, e nëse gjykata vlerëson se të pandehurit duhet t'I shqiptohet denim me burgim, atëherë I njejtë t'I zëvendësohet me denim me gjobë.

I pandehuri në fjalën e tij përfundimtare, deklaroi se mbetet pranë asaj që e ka thënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit, manifestohen të gjitha tiparet e veprës penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së.

Me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën e ngarkon aktakuza në seancën e parë të shqyrtimit gjyqësor, ka premtuar para gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, bazuar në evidencën e gjykatës I njejtë nuk është përsëritës I këtyre apo veprave tjera penale, ndërsa si rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti dëmin e shkaktuar pyllit të mbrojtur, të cilit I duhet kohë relativisht e gjatë për t'u rikuperuar, ndërsa dihet se I njejtë luan një rol kritik edhe në shëndetin e njerëzve, sa i përket ajrit të pastër, por edhe në ruajtjen e ekuilibrit ekologjik.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin B.K, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë tek i pandehuri

dhe personat tjerë që të shmangen nga kryerja e veprave penale, dhe të forcojë detyrimin për respektimin e ligjit, dhe me këtë edhe të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit, i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është i bazuar në dispozitën e nenit 449 të KPP-së.

Vendimi për taksën në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit është marrë konform nenit 36 par.3 nenpar.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për kërkesën pasurore jurididike, është i bazuar në dispozitën e nenit 462 par.2 të KPP-së.

Gjykata, bazuar në nenin 92 par.1 të KPRK-së dhe nenin 269 par.1 të KPPK-së, të pandehurit i konfiskon mjetin transportues tip Pickup të markës “...” ngjyrë e bardhë, me targa, 05-136-EF, dhe një motor sharrë e tipit “...”, meqë gjatë seancës shyrtimit gjyqësor, u vërtetua se të njëjtat, janë mjete me të cilat është kryer vepra penale në fjalë.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

### **DEGA KAÇANIK**

**P.nr.182/21 datë 04.06.2024**

Bashkëpunëtori profesioanl  
Ismajl Kuçi

Gjyqtarja,  
Zajrete Muhaxheri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.